



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2710/Prot.
1

Patos, më 09/10 2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 8 TETOR 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve, Njësia Administrative Zharrëz

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjuesë publike me temë: “Prezantimi përfundimtar i Paketës Fiskale 2026”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetar i bashkisë z. Sokol Meta, Anëtarë GMS dhe përfaqësues të bashkisë Patos, administrator i njësise administrative Zharrëz, rreth 21 pjesëmarrës (banorë dhe kryetarë të fshatrave)

Takimin hapet nga Zv /Kryetar i bashkisë z. Sokol Meta

Zv /Kryetar i bashkisë z. Sokol Meta - të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Zv /Kryetar i bashkisë
z. Sokol Meta**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Prezantimi përfundimtar i Paketës Fiskale
2026”**

Tetor 2025

pjesë të kësaj dëgjese publike. Sot do të prezantojmë Paketën Fiskale për vitin 2026. Ju ftoj të gjithëve të ndiqni prezantimin dhe nëse keni pyetje ose sugjerime mund të na i drejtoni pas prezantimit të materialit.

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj – përshëndetje të gjithëve! Në këtë dokument do të prezantohen propozime të Bashkisë për



**Drejtor
z. Çajup Refitaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

sistemin e taksave dhe tarifave për periudhën një vjeçare. “Tatim” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që nuk bëhet në shkëmbim të mallrave dhe shërbimeve të caktuara. “Taksë” është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit apo në buxhetin e organeve të qeverisjes vendore, e vendosur me ligj dhe që paguhet nga çdo person, që ushtron një të drejtë publike apo përfiton një shërbim publik në territorin e Republikës së Shqipërisë. “Tarifë” është një pagesë, që një individ, person fizik apo juridik, bën drejtpërdrejtë apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore. Tarifa paguhet në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë të mire publike specifike të përdorur, apo të drejtë të dhënë. “Tatimpagues” është personi apo individ, i cili detyrohet nga ligji të paguajë tatime, taksa ose kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe personi që llogarit dhe mban tatimin në burim. “Taksapagues” është çdo individ, person fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i cili është i detyruar të paguajë njërën nga taksat kombëtare. Riklasifikime të taksave dhe tarifave ekzistuese, prezantimi i tarifave të reja, përcaktimi i qartë i llojit të taksave/tarifave, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Baza ligjore mbi të cilën jemi bazuar për ndërtimin e Paketës Fiskale Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Llojet e taksave që propozohen për vitin 2026 janë: Taksa mbi

pasurinë e paluajtshme, taksa e fjetjes në hotel, taksa e ndikimit në infrastructure, taksa e kalimit të drejtës së pronësisë, taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, taksa e Rentës minerare, taksa e Tabelës. Struktura e tarifës për 2026 është: Tarifa e Pastrimit për Familje, tarifa për Shërbimin Komunitar, tarifa e Pastrimit për Biznesin, tarifa e Gjelbërimit Biznes, tarifa e Ndriçimit Biznes, tarifa për shërbimet administrative, tarifa e shërbimit të transportit, tarifa e parkimit, tarifa për linjat ajrore dhe nëntokësore, tarifa për zënien e hapësirës publike dhe tarifa ndotje mjedisi. Taksa e ndërtesës në bashkinë Patos është taksa mbi pasurinë e paluajtshme, tarifa e Pastrimit dhe tarifa për Shërbimin Komunitar. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në ligj përcaktohen ndryshe. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën. Ndërtesa që përdoren dhe shfrytëzohen për banim para vitit 1993 ka një taksë prej 10.78 lekë/m² për bashkinë Patos dhe 9.80 lekë/m². Ndërtesa që përdoren dhe shfrytëzohen për banim pas vitit 1993 ka një taksë prej 15.40 lekë/m² për bashkinë Patos dhe 14 lekë/m² për njësitë administrative. Ndërtesa që përdoren dhe shfrytëzohen për veprimtari ekonomike (tregëti dhe shërbime) ka një taksë prej 109.2 lekë/m² për bashkinë Patos dhe 92.4 lekë/ m² për njësitë administrative. Përjashtimet nga taksa e ndërtesës përfitojnë pronat e shtetit, Komunitetet fetare, banesat e ndërtuara para vitit 90 dhe janë të privatizuara, kanë 30% ulje, ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët ose dhe me persona në ngarkim të tyre që janë të paaftë për punë. Ndërtesat e kryefamiljarëve që janë në skemën e ndihmës ekonomike. Taksa mbi tokën bujqësore të cilën duhet ta paguajnë të gjithë ata që kanë përfituar tokë. Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Ky detyrim paguhet në një këst. Afati i pagesës është data 30 Dhjetori, por për të gjithë përfituesit e tokës bujqësore në raste se do të bëjnë pagesën brenda 8/mujorit të parë propozojmë të lehtësohen në 20 % të detyrimit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formulari 6, akti i pronësisë, certifikatë e regjistrimit të tokës. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie. Përjashtohen nga taksa mbi tokën bujqësore. Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes. Kur pasuria është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga Këshilli Bashkiak në raport me dëmin e

shkaktuar deri në vlerën 75 %. Tarifa e Pastrimit në Njësinë Administrative Patos për vitin 2026 ngelet në nivelet ku në familjet e përbëra nga 1 deri në 2 persona në çertifikatën familjare tarifa është 3,900 lekë / viti, Familjet e përbëra nga 3 ose më shumë persona në çertifikatën familjare janë 5,100 lekë / viti. Tarifa për shërbimin komunitar do të jetë 1,500 lekë / viti. Në total një familje në Njësinë Administrative Patos do të paguajë 5,400 lekë deri në 6,600 lekë për tarifën e pastrimit dhe tarifën e shërbimit komunitar për vitin 2026. Lehtësirat fiskale për Tarifën e Pastrimit dhe Tarifën e Shërbimit Komunitar do të kenë Familjet e veteranëve niveli i tarifave do të jetë 0 lekë (theksojmë nuk përfitojnë pasardhës veteranësh), Familjet që kanë persona me PAK niveli i tarifave do të jetë 0 lekë, Familjet e të përndjekurve politik niveli i tarifave do të jetë 0 lekë, Familjet që janë në skemën e ndihmës ekonomike niveli i tarifave do të jetë 0 lekë, Familjet ku janë vetëm pensionistë sipas çertifikatës familjare niveli i tarifave do të jetë 0 lekë. Një biznes do të paguajë: Ndërtesa, taksa mbi pasurinë e paluajtëshme, Trualli, detyrimi përcaktohet sipas llojit të aktivitetit & sipërfaqja që ka biznesi, taksa e tabelë për sip. Mbi 2 m2, tarifa e pastrimit , gjelbërimi dhe ndriçimi. N Përfitojnë lehtësira fiskale për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit këto kategori:

- Emigrantët të cilët do të hapin aktivitet ekonomik gjatë vitit 2026 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
- Bizneset e reja që do të hapen ku numri i të punësuarve do të jetë mbi 10 gjatë periudhës 01.01.2026– 30.12.2026 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
- Për persona studentë të diplomuar në Universitetet Shterore vendase të diplomuar gjatë vitit 2026 niveli i tarifës do të jetë 0 lekë.
- Fermerët e pajisur me NIPT janë të përjashtuar nga pagesa e tarifave.

Tarifë vendore për urbanistikën (vetëdeklarim)

Personat fizik- 3000 lekë

Personat juridik- 5000 lekë

Taksë e ndikimit në infrastrukturë për kryerje punimesh të cilat pajisen me deklaratat paraprake:

- Personat fizik
- Personat juridik 1% e vlerës së investimit

Familjet në Njësinë Administrative Zharrëz & Ruzhdië do të paguajnë taksën mbi pasurinë e paluajtëshme, tarifa e Pastrimit, tarifa për Shërbimin Komunitar. Tarifë pastrimi: 1-2 persona = 3,900 lekë, 3 ose më shumë= 5,100 lekë dhe tarifë shërbimi komunitar 1,500 lekë. Ky ishte dhe prezantimi i Paketës Fiskale dhe pjesa e taksave dhe tarifave për njësinë tuaj. Ju ftoj me komentet dhe sugjerimet tuaja.

Banor i Zharrëzës, z. Faslli Hoxha- përshëndetje! Unë kam një çështje për taksat e kurorës më vete, pra me familjen e djalit që është e ndarë nga unë. Duhet të paguajmë të dy ne?



**Banor i Zharrëzës
z. Faslli Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

Çështja tjetër ka të bëjë me shtëpinë sepse nuk kam bërë truall shtëpie ambjentin, por tokë arë. Unë shtëpinë e kam në ajër dhe nuk kam dokumentacion. Kam tre vjet që kam paguar në hipotekë dhe akoma skam marr përgjigje për shtëpinë. Unë kam 1 ha ullinj atje e kam ullishte dhe nevoja për pastrim kanali është. Gjithashtu vuaj për një urë sepse unë nuk ngijtem dot me mjet lart pasi është e pamundur. Duhet edhe një rrugë dytësore aty.

Drejtori Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit- z. Çajup Refitaj– Ne kur bëjmë taksimin e familjeve i referohemi gjendjes së tyre civile, pavarësisht se ku jetojnë ata.



**Drejtor,
z. Çajup Refitaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

Taksën e ndërtesës e paguan pronari. Familja tjetër paguan tarifat. Lidhur me çështjen e dokumentit të objektit është kompetencë e Agjencisë Shtetësore të Kadastrës.

Administrator i njësisë Zharrëz, z. Riza Hoxha- për pjesën e urës ne kemi bërë si urë aty, por ka ngelur pa u sistemuar dhe së shpejti do përfundoj si punë.



**Administrator i njësisë Zharrëz
z. Riza Hoxha**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

Banore e Zharrëzës, z. Idajete Nuraj- Kam disa probleme. Duhet pastruar kanali, toka e malit duhet të rregullohet pasi uji më vjen dhe rrëshket e ka gërryer tokën. Por duhet pastruar kanali që të iki uji. Dua të shtrohet rruga dhe të vendoset ndriçimi të shtëpia ime pasi nuk ka ndriçim. Kërkoj që toka të kaloj në sistem që tua kaloj fëmijëve. Jam taksa paguese e rregullt. Rruga që u shtrua me çakull është bërë pluhur e gjitha.



**Banore e Zharrëzës
z. Idajete Nuraj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

Banor i Zharrëzës, z. Leonard Nako- Nëse është e mundur për buxhetin e ardhshëm pjesa e Dinallarëve lart te mali ka nevojë për shtrim me çakull aty ku kemi ullinjt, pasi është e



**Banor i Zharrëzës
z. Leonard Nako**

**Dëgjesë publike me temë:
“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

pamundur të kalosh. Janë diku te 40 fermerë aty. Duhet edhe polica të shtrir aty në atë zonë sepse ka shumë makina. Bashkia bën shumë punë të madhe dhe shtron dhe rrugë. Duhet ti përmbyll edhe me sinjalistika që të duken të plota si rrugë.

Drejtor i ASHP, Z. Eneo Xhaferi- Janë shumë rrugë në njësinë Zharrëz që po punohen. Në 2026 kemi disa rrugë të arashikuara, por për këtë vit nuk e mbyllim dot atë rrugë. Në 2026 do ta bëjmë dhe këtë rrugë. Edhe policat e shtrir ne i kemi zvendësuar, por ato duhen ndërruar sepse kalojnë shumë kamiona dhe makina dhe prishen. Edhe vijëzimet e rrugëve dhe sinjalistikat janë bërë për çdo rrugë.



**Drejtor i ASHP
z. Eneo Xhaferri**

Dëgjësë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

Kryetar i fshatit Frashër, z. Irakli Zarka- unë kam një shok që ka vëllezërit jashtë dhe ky u paguan taksat. Ata kanë vetëm tokë, shtëpi nuk kanë. Ata thonë pse ti paguajnë tarifat e gjelbërimit.



**Kryetar i fshatit Frashër
z. Irakli Zarka**

Dëgjësë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

Drejtor, z. Çajup Refitaj- Kjo është një çështje që e kemi diskutuar për emigrantët, por nuk



**Drejtor
z. Çajup Refitaj**

Dëgjësë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

kemi një zgjidhje pasi nuk kemi akses në hyrje daljet e atyre që jetojnë dhe lëvizin jashtë vendit. Nuk kemi gjetur një mekanizëm se si mund ti përjashtojmë emigrantët nga tarifat dhe paketa fiskale.

Kryetar i fshatit të Ri, z. Bexhet Rredhi- Në fshatin tonë taksat paguhën. Nuk kemi kosha



**Kryetar i fshatit të Ri
z. Bexhet Rredhi**

Dëgjësë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

mbeturinash dhe ndriçim. U fol që do vendoseshin kosha në çdo familje, por nuk kemi parë reagim lidhur me këtë çështje.

Përgjegjës ASHP, z. Ardit Ngjeliu- koshat do të vendosen. Jemi duke pritur bazën materiale



**Përgjegjës ASHP
z. Ardit Ngjeliu**

Dëgjësë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

të elektrikeve, ndërsa për kosha kemi gjendje dhe do ti vendosim. Do vendosen dhe në çdo familje, por për momentin nuk ka bazë materiale për të gjithë njësinë.

Banor i Zharrëzës, z. Enver Hasani- ne jemi disa banesa pa kanalizime të ujërave të zeza dhe pa kanale kulluese. Ndriçim erdhi por, kanalizime jo, pastrim jo, si paguhën këto taksa kur nuk ka shërbim. Kam edhe atë ankesën për objektin e vjetër që e kam ngritur në çdo dëgjësë. Rrezikon të bjerë ai objekt. Gjithashtu edhe problemi shpërblimit të lindjes, dy nipërit e mi nuk e kanë marrë kanë shumë kohë.

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Nëse nuk keni sugjerime të tjera dhe kërkesa e deklaroj të mbyllur këtë dëgjesë publike. Ju faleminderit!



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Prezantimi përfundimtar i Paketës
Fiskale 2026”**

Tetor 2025

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Armand Ahmetaj